



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

---

## KONTRATA

Numri i kontratës: **101-21-4184-2-3-6/C60**

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;  
dhe

**AGIMI-DE, NT, Deçan**, Sheshi Mentor Tolaj, E-mail: agimide.print@gmail.com; Tel.: +383 44 635 635;  
Numri fiskal: 600050603 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin  
një kontratë publike:

**Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën VII**  
me numër prokurimi **101-21-4184-2-3-6 (KU101 21 014 236)**.

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën VII**

1.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e kontratës (09.08.2021) dhe përfundon me  
implementimin e kontratës (30.08.2021).

1.3 Afati kohor i performancës (dorëzimit të Raporteve të shtypura) nuk mund të jetë më shumë  
se **20 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së  
Kosovës

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të  
Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068  
dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbuloohen me dispozita të kontratës, zbatohen  
ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,221.00 € (Tremijedyqindenzetenjë euro)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti  
Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të  
mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të  
atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat (Raportet)* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *Raporteve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës (Shih **KVK**)

## **Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe <sup>2</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

## KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</li> <li>• Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe dhe Serbe.</li> </ul>
Siguria e ekzekutimit		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 12 muaj.</li> </ul>
Pagesat	4	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shërbimet duhet të jenë në pajtim me specifikimin teknik në Dosje të tenderit</li> <li>• Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesën operatorit ekonomik pas kryerjes së shërbimeve e furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se shërbimet dhe furnizimet janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</li> <li>• Raportet për shtypje (printim) do t'i dorëzohen OE fitues të kontratës, në mënyrë elektronike, me rastin e nënshkrimit të kontratës.</li> </ul>
Vonesat në ekzekutim	8	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëme të likuiduara Autoriteti Kontraktues, për vonesë në furnizim, operatorit ekonomik mund t'ia kalkulojë dëmet e likuiduara 0.25% në ditë deri në 10% të vlerës së kontratës.</li> </ul>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	13.1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese.</li> </ul>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.2	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</li> </ul>

**Shënim:**

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare të Operatorit ekonomik dhe kopja e sigurisë së ezekutimit.

Për Autoritetin Kontraktues <b>KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b>		Për Operatorin ekonomik <b>Agimi-De, NT</b>	
Emri dhe mbiemri	Xhemal Halili	Emri dhe mbiemri	Agim Selmanaj
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.08.2021	Data:	09.08.2021
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

Titulli: Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën VII

Nr. i Prokurimit: 101-21-4184-2-3-6 dhe Nr. i Brendshëm: KUI01 21 014 236

PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

Nr. r.	Emërtimi	Përshkrimi - Karakteristikat - dimensionet	Njësia matëse	Sasia	Çmimi pa TVSH	TVSH (%)	Vlera e TVSH	Çmimi me TVSH	Totali me TVSH
				a	b	c	c	d = b + c	e = a x d
1	Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën VII - në gjuhën shqipe	<ul style="list-style-type: none"><li>• Faqe 226</li><li>• Formati A5</li><li>• Letra e bardhë 80 g</li><li>• Shtypja të bëhet në kolor (me ngjyra)</li><li>• Kopertinat e trasha (me lidhje të fortë - me qepje) dhe kolor</li><li>• Mbishkrimi përveç pjesës balllore të jetë edhe në pjesën anësore të kopertinës me emrin e plotë të raportit.</li></ul>	copë	500	2.50	18%	0.45	2.95	1,475.00



2	Shtypja e Raportit Fund- Mandator për Legjislaturën VII - në gjuhën serbe	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqe 211</li> <li>• Formati A5</li> <li>• Letra e bardhë 80 g</li> <li>• Shtypja të bëhet në kolor (me ngjyra)</li> <li>• Kopertinat e trasha (me lidhje të fortë - me qepje) dhe kolor</li> <li>• Mbishkrimi përveç pjesës balllore të jetë edhe në pjesën anësore të kopertinës me emrin e plotë të raportit.</li> </ul>	copë	300	2.46	18%	0.44	2.90	870.00
3	Shtypja e Raportit Fund- Mandator për Legjislaturën VII - në gjuhën angleze	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqe 222</li> <li>• Formati A5</li> <li>• Letra e bardhë 80 g</li> <li>• Shtypja të bëhet në kolor (me ngjyra)</li> <li>• Kopertinat e trasha (me lidhje të fortë - me qepje) dhe kolor</li> <li>• Mbishkrimi përveç pjesës balllore të jetë edhe në pjesën anësore të kopertinës me emrin e plotë të raportit.</li> </ul>	copë	300	2.47	18%	0.45	2.92	876.00
<b>GITHSHEJ OFERTA ME TVSH</b>									<b>3,221.00</b>



**Shënim:**

Operatorët ekonomikë janë të obligueshëm t'i plotësojnë rubrikat: Çmimin pa TVSH dhe TVSH-në. Operatorë ekonomikë duhet t'i japin cmimet reale të tregut për produktet (mallin) e ofruar. Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

<b>IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK</b>	
EMRI I KOMPANISË	NT AGIMI DE (HAJRUE SELMANAJ B.I)
ADRESA E PLOTË	SHESHI MENTOR TOLAJ DEÇAN 51000



PERFAQESUAR NGA:

EMRI


HAIRIJE SELMANUJ

POZITA

NËNSHKRIMI

DATA

VULA

  
09.07.2021







# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 96007

Për **KUVENDI I KOSOVËS**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **N.T. "Agimi- De" - Hajrije Selmanaj B.I.**

(Emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Shtypja e Raportit Fund-Mandator për Legjislaturën VII**

Nr. prokurimit: 101-21-4184-2-3-6, Nr. brendshëm, KU101 21 014 236

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci,

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **322.10€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **322.10€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 396 ditë kalendarike prej **09.08.2021** deri më **09.09.2022**

Data lëshimit: 09.08.2021

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

